


TRIBUNA SINDIKALE

Dhjetor 2006

Dhe drit' e diturisë
përpara do na shpjerë



Editorial**TE ZBATOJME ME KORREKTESI E PERGJEGJESI
KONTRATEN KOLEKTIVE TE PUNES**

Kane kaluar pothuajse 6 muaj nga nenshkrimi i Kontrates se re Kolektive te Punes midis Ministrise se Arsimit dhe Shkences, nga njera ane dhe sindikatave te arsimit FSASH e SPASH, nga ana tjetere, per periudhen 4 korrik 2006 - 31 dhjetor 2009. Te dy palet nenshkruese e kane konsideruar momentin e nenshkrimimit te ketij akti si nje arritje dhe baze per zhvillimin e nje dialogu social te efektshem dhe kane shprehur gatishmerine per zbatimin korrekt e ne pergjegjesi te dispozitave te saj.

Por, zbatimi i kerkesave dhe pambajtjes se KKP eshte proces i gjate dhe me i veshtire se sa negocimi dhe nenshkrimi i saj. Ky proces zbatimi nuk eshte vetvetiu, sepse, sidomos ne nivelin e dyte, ne disa DAR e ZA, per te mos folur per drejtorit shkollash, ka pergesa e veshtiresi ne zbatimin e neneve te Kontrates, ka moskuptime te pambajtjes se saj dhe aty-ketu ndemerrren edhe veprime qe jane ne kundërshtim te hapur me Kontraten Kolektive te Punes, megjithese kjo eshte nje dokument i detyrueshem per zbatim nga cdo punohes ne nivelin e dyte.

Shpëtsimet me te madha me te cilat ndeshemi deri tani lidhen me marrëdhëniet e punes, me emrimet dhe largimet nga puna. Keshtu, Zyra Arsimore ne Devoll, ka ndemarre veprime qe vijne ne kundërshtim te hapur me Kodin e Punes, Kontraten Kolektive te Punes dhe Udhëzimin nr. 29 date 18.09.2006 te Ministrimit te Arsimit dhe Shkences. Drejtori i kesaj Zyre, ne kundërshtim flagrant me aktet ligjore qe përmenden, pushon nga puna 12 mesues e mesuese te ketij nrethi dhe, megjithë ndërhyrjet e Seksionit Sindikal te FSASH per nrethin e Devollit, nuk i ka kthyer akoma ne pune.

Kryesia e FSASH i ka denoncuar keto shkelje ne MASH dhe ka kerkuar ndërhyrjen e Ministrimit per korrigjimin e shkeljeve ligjore. Pergjigja e funksionarave te MASH eshte se do te ndërhyhet me urgjence dhe keto shkelje te randa do te korrigjohen. FSASH e ka bere te qarte se do te prese deri me daten 15 dhjetor zgjidhjen e ketyre kerkesave dhe nbas ketij afati do t'i drejtohet Gjykates se Korces, duke i denoncuar shkelesit e Kontrates Kolektive te Punes dhe duke kerkuar kthimin ne pune te mesuesve te

larguar padrejtesisht, caktimin e tyre ekonomik dhe moral per periudhen qe ata jane larguar nga puna.

Nje problem i ngjashem eshte shfaqur edhe ne Zyren Arsimore Pogradec, ku jane larguar nga puna ne kundërshtim me Kontraten Kolektive 10 mesues. Moas ndërhyrjeve kembengulese te Seksionit Sindikal te FSASH ne Pogradec dhe te Kryesise se FSASH, ka reaguar edhe Ministria e Arsimit e Shkences. Jane kthyer ne pune disa nga keta mesues, por shumica e tyre akoma vazhdojne te sorollaten rrugeve.

Kryesia e FSASH e konsideron te nevojshme qe t'u beje edhe nje here me dije ne menyre publike drejtuesve te Drejtorive apo Zyrave Arsimore se Kontrata Kolektive e Punes, sic thuhet edhe ne Udhëzimin nr. 29 date 18.09.2006 te Ministrimit te Arsimit e Shkences, eshte nje dokument baze ligjor per kriteret e punesimit, transferimit dhe largimit nga puna te mesuesve, punonjese e drejtuesve ne gjithe sistemin e arsimit parauniversitar. Per pasoje, shkelja e dispozitave te kesaj Kontrate nga kushdo, e ngarkon shkelesin me pergjegjesi te randa. Ne kete pergjegjesi nuk ben pjese vetem detyrimi per te kthyer ne pune mesuesin apo mesuesen e larguar padrejtesisht duke i paguar edhe mrogen per gjithe kete periudhe, por edhe caktimi ekonomik dhe sanksioni moral.

Midis shkeljeve e mangesive ne zbatimin e KKP, pervec neglizhences ose kundërvënies, sic pershkruam me sipër, ka edhe probleme te kuptimit te pambajtjes se Kontrates, te harmonizimit e bashkeveprimit te saj me gjithe kuadrin ligjor te marrëdhënieve te punes, sic jane Kodin i Punes, Konventat Nderkonbetare te Punes, vendimet e Qeverise dhe Udhëzimet e Aktet Normative qe nxjerr Ministri i Arsimit dhe Shkences.

Per t'u njohur me gjithe kete kuader ligjor FSASH e SPASH po negociojne me punedhënesin, me MASH, qe te organizohet nje seminar nje ose dy ditor me Drejtues te DAR dhe ZA si dhe kryetare te seksioneve sindikalee te te dy sindikatave. Kjo do te ndihmoje per zbatimin drejt dhe ne kthe te dispozitave te KKP, te cilat jane ne thelb shlyese dhe mbeshtetje per reformimin dhe modernizimin e arsimit ne verdin tone.

PERMBAJTJA*Editorial:*

- ✓ Te zbatojme me korrektesi e pergjegjesi Kontraten Kolektive te Punes 2
- ✓ Shperblimi per "Nevoja madhore ne arsim", - domosdoshmeri 3
- ✓ Plotesimi i standardeve europiane ne arsim
- ✓ Botohet kuadri i perbashket Evropian i referencave per gjuhët 7
- ✓ U zhvillua Konferenca Pan-Europiane e Sindikatave te Arsimit 8
- ✓ Ambicie dhe autonomi, (nga Kongresi i AOB) 9
- ✓ Me optimizem per arritje te reja, (nga Murat Gecaj) 10
- ✓ Nga Mesonjetorja e Korces te Mesonjetorja e Londres, (nga Kristaq Laka) 11
- ✓ Te reja shkencore dhe keshilla praktike 15

Kopertina e pare:

Kolektivi i mesuesve te Shkolles 9-Vjeçare, Bathore, Kamez

Kopertina e fundit:

Grupi i Punes per eliminimin e punes se femijeve ne shkollen "Dino Ismaili", Levan, Fier

TRIBUNA SINDIKALE**Nr. 25, Periodike**

*Botim i FSASH dhe SPASH
ADRESA: Bulevardi "Zogu i Pare"
Pallati Ali Kelmendi, kati III,*

Tel: 22 83 46

Tel & Fax: 25 65 32

E-mail: fsash@icc-al.org

Keshilli Botues:

Xhafer Dobrush,

Bajram Kruja,

Lumturi Mataj,

Defrim Spahiu,

Petref Çelaj,

Aleks Dushi,

Stavri Liko, Kryeredaktor

Shperblimi per "Nevojat madhore Ne arsim", - domosdoshmere

Ne Kontraten e re Kolektive te Punes jane perfshire per here te pare disa dispozita qe synojne te fillojne dhe konsolidojne praktika shperblimi per mesuesit si motivim per punen cilesore qe ata bejne si dhe per perballimin e veshtiresive te vecanta. Nje nga keto dispozita eshte edhe ajo qe pershkruhet ne nenin 8 pika 8, shkrorja "a", e cila thote: "Kur jani perpara kerkesave qe lidhen me

qe ne fillim duhet thare se ne kete rast nuk kemi te bejne me nje kerkese te thjeshte ose te zakonshme. Perkundrazi, ne kete dispozite eshte parashtruar nje ide qe ka nevojte te shpjegohet, argumentohet dhe formozohet, duke u veshur edhe me kuadrin ligjor perkates. Ideja eshte ne funksion te zbatimit te perparesise: arsim cilesor publik me shanse te barabarta per te gjithte.

te mesme, ashtu edhe ne ato 9-vjecare, ndeshemi me mungesa te theksuara per mesues me kualifimin perkates. Keto mungesa jane me te theksuara per mesues qe kane mbaruar shkencat matematike, informatiken, fiziken, gjuhen anglisht, por edhe per disiplina te tjera, sic eshte gjuha shqipe, gjuhe te tjera te huaja, kimi, biologji, histori, muzike e deri te fizikultura.

Kjo gjendje nuk mund te kaperohet me masa gjysmoke dhe ne thelbe te padrejta, sic ishte vendimi per te shperblyer me stimulim ne page mesuesit e matematikes e informatikes me 1200 leke ne muaj.

Sindikatat e Arsimit kane qene dhe ribeten kunder kesaj zgjidhjeje, e kane kundershtruar dhe do ta kundershtrone ate. Dy jane argumentet e sindikatave kunder shteses ne page per mesuesit e matematikes dhe informatikes ose qofte edhe ndonje specialitet tjetër.

Se pari, diferencimi ne pagen mujore, sipas disiplinave ku jane diplomuar mesuesit perben shkelje flagrante te drejtave te mesuesve qe kane fituar titullin "mesues" ne disiplina te tjera. Konventat Nderkombetare te Punes dhe Karta Sociale Europiane, qe perbejne standardet e marredhenieve te punes, percaktojne qarte se per pune te barabarte dhe kualifikim te barabarte ka edhe page te barabarte. Vendimi per te shperblyer kete kategori mesuesish me 1200 leke ne muaj vjen ne kundershtrim me nenin 8 pika 2 te KKP, ne te cilin thuhet: "Punedhenesi dhe punemarresi bien dakord qe, ne baz e te



nevoja madhore ne arsim, sic eshte rasti kur ne zona te thella apo te largeta rurale, ose so perjashtim edhe ne zona urbane, ka mungesa mesuesish me arsim perkates, drejtoret e DAR ose ZA, mbasi marrin mendimin me shkrim te partnereve sindikale vendore, mund te emrojne dhe dergojne ne keto vende pune mesues me kualifikimin perkates, vetem me kontrate njevjecare, e cila mund te perseritet, duke i paguar sipas vendimeve ne fuqi".

Cili eshte kuptimi dhe synimi i vertete i kesaj dispozite?

Te gjithte e dime se per t'iu pergjigjur kesaj kerkese, pra per te bere realitet arsimin cilesor publik, duke krijuar shanse te barabarta per te gjithte, kerkohen ne radhe te pare mesues te kualifikuar. Ketu nuk behet fjale per Tiranen ose qytete te tjera kryesore e me tradite ne arsim, por per cob skolle ne cob cep te vendit.

Eshte e njchur, gjithashtu, se kur ballafaqojme kete kerkese me gjendjen, me realitetin ne shume skolla e rrethe te vendit, sidomos ne zona rurale, si ne rastin e skollave

Vijon nga faqja 3

dispozitive të Kodit të Punës, të Kartës së Lirive dhe të Drejtave të Njeriut dhe të Kartës Sociale Europiane, të garantojnë për të punësuarit page të barabarta për punë të barabarta dhe profesion të njëjte, pa asnjë dallim."

Diskriminimi i mesuesve të lendeve të tjera, në raport me ata të matematikës ose informatikës duket sheshit, sidomos në ato shkolla që i kanë të plotësuar nevojat për mesues në të gjitha lëndët.

Se dyti, sindikatat e arsimit kanë konsideruar se masa e shpërblimit për 1200 leke në muaj nuk përben motivim. Nga vlera e ulet që kjo masë përfaqëson nuk mund të shërbejë si nxitje as për studentet për të ndjekur degët e matematikës e informatikës, as për mesuesit për të shkuar në ato vende ku ndjehet me shumë nevojë për ta.

Ideja që kanë parashtruar sindikatat për shpërblimin që lidhet e kushtëzohet me kërkesën

"Për nevojë më të madhe në arsim" është dëgjuar krejt tjetër. Në këtë rast mbahet parasysh realiteti që është krijuar, si këtu edhe në arsim, në këta 15 vjet të tranzicionit. Levizjet e mëdha të popullsisë drejt kryeqytetit dhe qendrave të mëdha urbane, kanë sjellë edhe levizje të mesuesve. Në kryeqytet janë përqendruar me mijëra mesues nga të gjithë specialitetet, që janë në prituri për t'u punësuar në arsim. Nga ana tjetër, përveç Universitetit të Tiranës, edhe në Universitetet e Shkodrës, Elbasanit, Korçës, Gjirokastrës, Vlores, diplomohen çdo vit qindra e qindra mesues në të gjithë specialitetet e mesuesisë dhe që synojnë të punësohen në kryeqytet ose në qendra të qyteteve të mëdha urbane. Pra nuk është se nuk ka mesues, por ata, nga pikepamja e vendbanimit të

perhershëm apo të perkoheshëm janë polarizuar në dy grupe. Nga një anë, në kryeqytet dhe në qytetet e mëdha që përmenden ka shumë mesues të arsimuar e specializuar që janë pa punë dhe në prituri. Nga ana tjetër, në shumë zona rurale, përfshirë edhe disa qytete në periferi të vendit ka mungesë të theksuar për mesues të kualifikuar.

Problemi është: Si të mundësohet që kjo masë e madhe mesuesish të arsimuar e kualifikuar që presin për të filluar punë në arsim atje ku ata synojnë, qoftë edhe në sektore të tjera që mund të paguhet më mirë, të terhiqen në ato vende pune, në ato shkolla e rrethe ku ka nevojë jetike për ta, ku nxenesit i presin?

Një nga menyrat për ta zgjidhur ose zbutur këtë zgjidhje është propozimi i sindikatave të arsimit për një shpërblim të diferencuar, që në rastet më ekstreme mund të arrijë deri në një pagë plus. Kjo do të thotë që Drejtoritë Arsimore Rajonale ose Zyrtë Arsimore, të studjojnë nevojat që kanë për mesues në arsim përkatës në çdo shkollë të territorit të tyre dhe të shpallin ato vende për të cilat nevojë është shumë e madhe, ku mungesa e mesuesve me kualifikim përkatës çon formimin bashkëkohor të nxenesve.

Për të gjitha këto vende që plotësimi i tyre konsiderohet si plotësim i një nevojë më të madhe në arsim, DAR dhe ZA, duke marrë edhe mendimin e Seksioneve Sindikale, ofrojnë pagesa plus, sic e thamë deri në një pagë. Masa konkrete e pages plus për çdo mesues që pranon këtë ofertë përcaktohet në raport me largësinë e vendit të punës, me ndryshimin e vendbanimit, por mbi të gjitha me natyrën e nevojës që paraqitet për secilin mesues vec e vec.

Në këtë rast, çdo mesues që përfshihet në punësimin për nevojë

më të madhe në arsim, punësohet vetëm me kontratë njëvjeçare. Kjo do të thotë se, nëse gjatë vitit DAR ose ZA i krijohen mundësi e kontigjente mesuesish brenda zonave ose rrethit që ato mbulojnë, në vitin pasardhës nuk përsërisin kontratën me mesuesit që kanë ardhur nga larg, por i zëvendësojnë ata me mesues vendas.

Krijimi i praktikës për të ndërtuar një sistem shpërblimi për nevojë më të madhe në arsim, nuk ka parasysh që këtu bëhet fjale për disa mijëra mesues. Në rastin më të mirë këtu bëhet fjale për disa qindra, të cilët do të plotësojnë ato vende që janë të domosdoshme dhe vendimtare për të ruajtur nivelin cilësor të procesit mesimor në shkollë.

Përveç kësaj, në nuk pretendojnë që kjo ide apo kërkesë të plotësohet në një tërësi të lapsit. Ajo kërkon të studjohet nga specialiste e grupe të përbashkëta të punëdhënësit dhe sindikatave, kërkon të llogariten mirë efektet financiare, të cilat mund dhe duhet të mbulohen brenda buxheteve ekzistuese dhe mbi të gjitha, mbasi problemi të studjohet nga shumë anë, të hartohet edhe kuadri ligjor përkatës.

Ky është qëllimi i sindikatave, që kanë përfshirë në Kontratat Kolektive të Punës dispozitën për shpërblimin për nevojë më të madhe në arsim. Natyrisht, nëse në do të mjaftoheshim vetëm me përfshirjen e dispozitës në KKP nuk do të arrinin asgjë. Përkundrazi, diskutimi i përmbajtjes dhe qëllimit të kësaj dispozite me predispozicionin që të gjejnë me të mirën do t'i shërbejë jo vetëm motivimit me të mirë të mesuesve, por mbi të gjitha mritjes së cilësive të mesimit e shërbimeve që ofron shkolla, gjë që është jo vetëm kërkesë e kësaj, por edhe qëllim i përbashkët i Ministrisë Arsimi dhe Shkencës, Qeverisë, Sindikatave dhe gjithë shoqërisë.

Xhafer Dborushi
Kryetar i FSASH

Plotësimi i standardeve europiane në arsim nuk mund të realizohet pa trajnimin dhe kualifikimin e stafit mësimdhënës

Vendosmëria për kryerjen me sukses të reformave në arsimin shqiptar tashmë është bërë fakt i njohur për opinionin e gjerë publik, por njëdhësisht edhe për organizmat ndërkombëtare. Kjo është e evidente

një kulturë dhe përgatitje të lartë profesionale. Duke qenë se jetojnë e punojnë në një periudhë, ku teknologjia e sotme moderne na ofron një "lum informacioni" për të gjitha fushat e jetës nëpërmjet internetit dhe

nënyrë individuale. Por, këtu fjala është për sistemin e organizuar që drejtohet dhe monitorohet nga institucione të specializuara siç janë Q T K A, Instituti i Kurikulave dhe i Standardeve, Q K A V P - ja, etj., të



sidomos kohët e fundit dhe pasqyrohet qartë, në vlerësimin e Raportit të Komisionit Europian për Shqipëri në ku, në veçanti theksohet progresi i arritur në fushën e Arsimit. Për arsimin shqiptar tashmë shtrihen një sërë sfidash tepër të vështira, zgjidhja e të cilave varet të tjerave kërkim detyrimisht

shkëmbimit të informacionit orë lire, mundësitë për të thithur të rejtat bashkëkohore të nevojshme për çdo profesion janë të mëdha e nga në të ndryshmet. Edhe në fushën e arsimit e të shkencave pedagogjike kjo gjë është tepër e mundur për secilin që dëshiron të zgjerojë njohuritë e tij në

cilat disponojnë mjetet dhe specialistët përkatës për zhvillimin e kualifikimit të mësuesve sipas kriterëve bashkëkohore. Vërehet se, në këtë drejtim një bashkëpunim i mirë është vendosur midis DAR të qytetit të

Vijn nga faqja 5

Tiranës dhe institucioneve të sipër përmendura, për trajnimin dhe kualifikimin e punonjësve të arsimit parauniversitar. Kjo përvojë e aplikuar me institucionet arsimore publike, duhet të shtrihet edhe me ato jpublike, të cilat vitet e fundit (numi i tyre është rritur çorbvit), përgjithësisht janë shndëruar në një alternativë konkurruese dhe aktualisht lehtësuese për problemet e mbingarkesës me nxënës që kanë shkollat 9-vjeçare e të mesme të Tiranës. Edhe për këtë kategori arsimimi pavarësisht infrastrukturës moderne që mund të disponojnë disa shkolla të veçanta (në Tiranë, Durrës, Shkodër etj.), nevoja për kualifikim me sisteme të organizuar është e domosdoshme. Duhet theksuar se, shembujt pozitivë nuk mungojnë edhe në shkollat jpublike. Në mënyrë të veçantë spikat bashkëpunimi i realizuar në tre vitet e fundit, midis kolegjit "TURGUT OZAL" dhe IKS e QIKA-së. Drejtoria e Përgjithshme e Kolegjeve turke e ka pasur gjithnjë prioritet të punës së saj bashkëpunimin me institucionet e specializuara të arsimit shqiptar në qendër dhe në bazë, duke i konsideruar ato partnere të rëndësishëm për realizimin e objektivave në procesin e edukimit dhe të nësimin, në përgatitjen e brezit të ri me njohuritë e nevojshme për të përballuar sfidat e kohës. Nisur nga ky këndvështrim, rrezja e veprimtarisë së kolegjeve turke (aktualisht funksionojnë veç Tiranës, në Durrës dhe Shkodër) asnjëherë nuk ka qenë e kufizuar vetëm brenda mureve të veta, pavarësisht nga potencialet financiare, infrastrukturore dhe intelektuale që disponon aktualisht.

Në këtë mënyrë, mërziturja e eksperiencës së specialistëve turq nga njëra anë dhe me ata shqiptarë nga

ana tjetër të konkretizuara në planet e punës të departamenteve, deri tani rezultojnë mjaft pozitive. Për të qar në tej rezultatet pozitive të këtij bashkëpunimi në kolegjin "TURGUT OZAL", sipas një plani të hartuar në bashkëpunim me QIKA - në dhe IKS - në me shtrirje gjatë gjithë vitit akademik, zhvillohet trajnimi dhe kualifikimi mësuesve, duke iu përgjigjur nevojave të tyre, si dhe kërkesave që dikton koha. Rëndësi e veçantë në trajnimin e kushtohet gërshtimit në raporte të balancuara, të procesit teorik me aktivitetin praktik që kryejnë mësuesit nën drejtimin dhe monitorimin e specialistëve të QIKAsë dhe IKS-së. Në përfundim të ciklit të gjithë mësuesit testohen dhe në bazë të rezultateve individuale certifikohen sipas niveleve. Mjaft e dobishme rezultoi bashkëpunimi vitin e kaluar, trajnimi e kualifikimi i mësuesve të kësaj shkolle me IKS-në, për t'i paraprirë praktikës së re të përdorimit të teksteve mësimore të reja me përzyjedhje, pavarësisht ndryshimeve kurikulare të veçanta që ka në programin lëndor shkolla "TURGUT OZAL". Kjo shkollë ka si specifike një programin ndryshe nga shkollat publike për lëndët (e shkencave ekzakte dhe të natyrës), të cilat zhvillohen me tekste të veçanta në gjuhën angleze, ndërsa kompjuteri fillon të nështet me programin lëndor e veçantë që në klasën e parë të ciklit të ulët. Veç kësaj, në nësimin në këtë shkollë përzgjidhen me anë të konkursit, duke aplikuar testime sipas metodologjisë bashkëkohore, të kontrolluara me mjete e logjistike moderne.

Këtë vit në bashkëpunim me Q T K A po zbatohet programi kualifikues teorik praktik i nësimdhënies me në qendër nxënësin, duke i paraprirë kjo procesit të ardhshëm të nësimdhënies me në qendër rezultatin. Zbatimi i këtyre procedurave kërkon një

kualifikim dhe trajnim sistematik të mësuesve e drejtuesve, duke pasur parasysh dhe evolucionin progresiv të shkencës e teknologjisë të botës së sotme moderne. "Nisur nga kjo pikëpamje dhe nga fakti se, kualifikimi nuk njeh kufij, ne e shohim të domosdoshëm bashkëpunimin me institucionet e specializuara të arsimit shqiptar dhe njëkohësisht, po aq të rëndësishëm ballafaqimin në veprimtari praktike mësimore edukative si, (olimpiada, konkurse, aktivitete social-kulturore, sportive, etj) midis nxënësve dhe mësuesve të shkollës "TURGUT OZAL", me shkollat e tjera publike", u shpreh me një sinqeritet mbresëlënës, zëvendës drejtori i Përgjithshëm i kolegjeve turke z. Hamza Tck.

"Asnjëherë nuk na ka munguar ndihma e kolegjeve shqiptarë drejtues të shkollave, të specialistëve të Drejtorisë Arsimore të Tiranës dhe të MASH-it," shprehet me entuziazëm e optimizëm të dukshëm, drejtori energjik i shkollës 9-vjeçare "TURGUT OZAL", z. Hamza Aksoy, që këtë bashkëpunim e cilëson si faktor shumë të rëndësishëm. Është e natyrisht se bashkëveprimi gjithëpërfshirës me faktorët kryesorë dhe elementet e trajnimit e të kualifikimit, së bashku me ballafaqimin konkurrues jashtë komizave kufizuese, në hapësira ballkanike, europiane, e me gjerë, do të garantojë me siguri progresin e dëshinuar dhe përsheptimin e plotësimin të standardeve europiane në arsimin shqiptar. Kjo bindje e plotë e konsoliduar tashmë në koncept institucional, ka mitur kërkesat për të krijuar kushte e mundësi të reja për realizimin e objektivave të larta që ka vendosur vet stafi nësimdhënës i kolegjit "TURGUT OZAL".

Josif DEVOLE

(Marre nga gazeta "Mesuesi")

BOTOHET “KUADRI I PËRBASHKËT EVROPIAN I REFERENCAVE PËR GJUHËT: MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA DHE VLERËSIMI”

Drejtorja e Zhvillimit të Kurrikulës në MASH, në dhjetor 2006, në mjediset e hotel “Mondial” në një mjedis profesionistësh të gjuhës së huaj promovoi botimin në gjuhën shqipe të “Kadrit të Përbashkët Evropian të Referencave (KPER) për gjuhët: mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi”.

Me këtë botim në gjuhën shqipe, vendi ynë vendoset përkrah vendeve që kanë përkthyer dhe kanë botuar

folën për rëndësinë e këtij botimi duke theksuar se mësimdhënia dhe mësimnxënia e gjuhëve të huaja në arsimin parauniversitar kanë thyer tradicionalizmin, duke zbatuar një metodologji bashkëkohore, e cila mbështetet në dokumente të rëndësishme të hartuara nga institucione të këmbëzues si Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, ku një nga këta është edhe dokumenti i sapobotuar.

Megjithëse nuk ka munguar

përmirësim të vazhdueshëm të materialeve didaktike kanë nevojë për dokumente të tilla udhëzuese dhe tashmë Kadri Evropian është në duart e atyre që do të punojnë me këto materiale.

Këshilli i Evropës me anë të “Kadrit të Përbashkët Evropian të Referencave” inkurajon organizimin e të mësuarit dhe të nxënies të gjuhëve të huaja, bazuar në punën, nevojat, motivimin, karakteristikat dhe burimet njerëzore në kuadrin e çdo vendi duke dhënë qëllime, strategji, objektiva dhe parime të pranuar bashkërisht nga shtetet anëtare të KE-së.

Kadri është dokumenti bazë mbi të cilin mbështetet ecuria e gjuhëve të huaja në shkallë evropiane. Ai standardizon procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit në gjuhë të huaj dhe kërkon që çdo shtet anëtar i KE-së ta kthejë në plan veprimi në mbështetje të politikave gjuhësore dhe institucioneve arsimore qëndrore që merren me hartimin e kurrikulave, vlerësimin, trajnimin fillestar dhe të vazhduar të mësuesve.

Kadri synon kapërcimin e barrierave në komunikim midis profesionistëve në fushën e gjuhëve moderne edhe pse ata vijnë nga sisteme të ndryshme arsimore në Evropë. Ai është një dokument i cili mbështet fuqishëm shumëgjuhësinë dhe multikulturën. Ky dokument u përkthye me profesionalizëm nga Prof. As. Dr. Andronaqi Haloçi, pedagogje në Fakultetin e Gjuhëve të huaja në Tiranë.

Tatjana Vuçani
Specialiste në DZHK



këtë dokument, duke realizuar një objektiv të punës së DZHK-së në MASH, por edhe duke pëmbushur një kërkesë të Këshillit të Evropës.

Në këtë veprimtari përshëndetën në emër të Këshillit të Evropës eksperti Viljo Kohonen, i cili mori pjesë në seminarin dyditor të organizuar nga DZHK për Portofolin Evropian të Gjuhëve, në emër të MASH Znj. Suzana Tabaku, drejtore e DZHK dhe Znj. Mimoza Gjokutaj drejtore e QKTA-së.

Të pranishmit në këtë veprimtari

njohja e profesionistëve dhe mësuesve të gjuhëve të huaja me këtë dokument nëpërmjet konferencave për gjuhë të ndryshme të zhvilluara në dy vitet e fundit, me botimin e tij do të kemi më shumë mundësi përdorimi nga një masë më e madhe të interesuarish.

Në këtë takim doli në pah se roli i mësuesit profesionist, evoluimi i procesit të mësimdhënies/nxënies, rëndësia e gjuhës së huaj për integrimin e vendit tonë në strukturat e BE-së, si dhe kërkesa për një

U zhvillua Konferenca Pan-Europiane e Sindikatave te Arsimit

Ne Luksenburg, ne ditet e para te dhjetorit, u zhvillua Konferenca Pan-Europiane e Sindikatave te Arsimit (PES) dhe Asambleja e Pergjithshme e Komitetit European te Sindikatave, ETUCE, ku moren pjese edhe perfaqesuesit e dy sindikatave tona te arsimit, FSASH dhe SPASH, z. Xhafer Dobrushki dhe Z. Defrim Spahiu.

Konferenca beri analizen e pune per tre vjetet e kaluara dhe percaktoi drejtimet kryesore te punes per periudhen tre vjecare ne vijim.

Tema kryesore e saj ishte "Mesuesit ne Europe: mundesia e levizjes dhe kualifikimit, punesimi, siguria e vendit te punes dhe shperblimi"

Konferencen e hapi Sekretari Nderkombetar i Sindikates se Arsimit te Gjermanise, GEW, dhe Zv/President i PES, Z. Christoph Heise, i cili komentoi arrijtet gjate tre vjeteve te para te veprimit te perbashket te Federates Evropiane te Sindikatave te Arsimit, EIE me ETUCE, si edhe disa nga veshtiresite qe jane ndeshur gjate kesaj periudhe.

Presidenti i Federates Nderkombetare te Sindikatave te Arsimit, EI, Thulas Nesi, i cili emoi fjalen ne sessionin e hapjes, analizoi punen e rajonit te Europes ne kontekstin global te punes se EI, duke theksuar sidomos nevojën per nje mbrojtje me te mire te arsimit parashkollor, mbeshtetjen e kualifikimit cilesor te mesuesve, mbrojtjen e te drejtave njerezore e sindikale dhe te barazise gjinore. Ne lidhje me te ardhmen e arsimit

publik dhe sindikalizmit ne arsim, ai theksoi nevojën e nje "vizioni social demokrat" per arsimin si nje proces social-kulturor ne te cilin alternativet ne lidhje me ideologjine dominuese jo vetem qe jane te mundshme, por edhe kane filluar te veprojnë.

Konferencen e pershendeti, gjithashtu, perfaqesuesi i Komisionit European, Zoti Gordon Clark, i cili vuri ne dukje disa nga aspektet aktuale te sherbimit te arsimit, ne te cilat eshte perqendruar ky Komision, duke u perqendruar tek nevoja per te mesuarit gjate gjithë jetes dhe arsimit parashkollor.

Koordinatori i EI per Europen Z. Charlie Lennon, Sekretari i Pergjithshem i ETUCE, Martin Romer, perfaqesuesja e sindikatave norvegjeze Zj. Haldis Holst, perfaqesuesi i sindikatave te Anglise, John Bangs, dhe perfaqesuesja e sindikates se Arsimit te Holandes, AOb, Zj. Trudi Kerperien, bene analizen e pjeseve te vecanta te tematikes se Konferences dhe theksuan nevojën e domosdoshme te nje statusi te nivelit te larte per mesuesit, duke vene ne dukje se "Nje shoqeri qe nuk respekton mesuesit, nuk mund te investoje per arsimin" dhe "Mesuesit duhen vleresuar e respektuar dhe duhet investuar per ta, duke u dhene atyre paga te mira dhe kohen e nevojeshme per ta bere sic duhet detyren e vete".

Konferenca miratoi disa rezoluta, midis te cilave edhe ate te propozuar nga sindikata e arsimit e Frances UNSA, ne te cilen denoncohen prirjet per ksenofobi, racizem, antisemitizem e sjellje te tjera te

rrezikshme per demokracine dhe afirmohet se "Mesuesit perkrahin vlera te tilla si barazia, solidariteti, vllazeria, vlera keto qe jane ne qozite me urrejtjen, perjashtimin dhe racizmin"

Me miratimin e rezolutave te vecanta, Konferenca mbeshteti mesuesit e Bullgarise, Greqise, Hungarise dhe Rumanise, te cilet jane duke luftuar, nepermjet veprimeve sindikale, si greva e demonstrata, per paga me te mira dhe kushte pune te pershtatshme per anetaret e vete mesues.

Duke analizuar nje propozim te sindikates se mesuesve te Holandes, ne lidhje me disa ndryshime ne perberjen dhe funksionimin e strukturave te PES dhe ETUCE, Konferenca ngriti nje Komitet te veçante per t'i ripare keto struktura dhe per te dale me propozime konkrete, sidomos ne lidhje me koordinimin me te mire midis tyre dhe per nje efektivitet me te larte ne veprimtarine e tyre.

Konferenca miratoi Programin e Koordinuar te Veprimeve, se bashku me buxhetin perkates, i cilet jane shume ambicioze dhe parashikojne nje sere politikash zhvillimi dhe aktivitetesh per periudhen e ardhshme trevjecare.

Konferenca zgjodhi Presidentin e ri te Struktures Pan-Europiane te sindikatave te arsimit, i cili eshte Sekretari i Pergjithshem i Institutit Skocez te Arsimit, Ronnie Smith, si edhe 6 zv/presidente, Sekretarin e Pergjithshem te ETUCE, z. Martin Romer, dhe anetaret e Komitetit Pan-European te Sindikatave te arsimit.

Stavri Liko

Ambicie dhe autonomi

Nga Kongresi i Sindikates Holandeze te Mesuesve, AOb

Kongresi i Katet i Sindikates se Pergjitheshme te Personelit te Arsimit te Holandes, AOb, ne te cilin moren pjese edhe dy drejtuesit e sindikatave tona te arsimit FSASH e SPASH, Z. Xhafer Dobrushi dhe Z. Bajram Kruja, i zhvilloi punimet ne Qendren e Kongreseve ne Arnhem, ne prani te delegatave perfaqesues te niveleve te

Ambicie, sepse mesuesit synojne te sigurojne arsim te nivelit te larte per nxenesit dhe studentet. Arsimi eshte dicka qe prodhohet ne bashkepunim, mesimndhenia eshte nje profesion qe kerkon pasion. Per te bere punen e tyre sic duhet, mesuesit kane nevojte qe te jene ne gjendje te percaktojne vete rrugen e tyre.

autonomia, per te cilat, para miratimit, u bere diskutime e debate te shumta.

Nderkohe perfaqesuesit e delegacioneve te huaja moren pjese ne dy workshope (seminare interaktive) ne lidhje me "aministrimin e mire" dhe "profesionalizmin ne kushte e nje shkolle autonome", ku u paraqit jo vetem pervoja e sindikatave dhe shkollave holandeze, por edhe ajo e vendeve te tjera pjesemarrrese ne Kongres, sidomos nga Franca, Spanja, Rusia etj.

Pjese e aktiviteteve te delegacioneve te huaja ne kuadrin e këtij Kongresi ishin dhe vizitat ne disa shkolle te niveleve te ndryshme te qytetit te Roderdamit, ku perfaqesit e ketyre delegacioneve u njohen nga afer me pervojten dhe problemet me te cilat ndeshen mesuesit dhe sindikatat e AOb ne punen e tyre per mbrojtjen e interesave te anetareve te vete.

Pjesemarrja e delegacionit te sindikatave tona ne kete Kongres ishte me shume interes per faktin se ato kane nje periudhe te gjate bashkepunimi me AOb dhe njohja nga afer e kesaj pervoje do te jete nje ndihme e drejtperdrejte per t'iu pergjigjur me mire kerkesave te ketij bashkepunimi.

Ne pershendetjen e bere ne emer te sindikatave shoqiptare ne kete Kongres u vleresua ndihma e dhene deri tani dhe u siguruan delegatet e Kongresit se shembulli i AOb do te ndiqet edhe nga ana e sindikatave tona, natyrisht ne perputhje me kushtet konkrete te vendit tone.



ndryshme te kesaj sindikate ne sistemin arsimor ne Holande.

Ne fjalen qe mbajti ne Kongres, Presidenti i AOb, zoti Walter Dresscher, pasi beri nje analize te punes, arritjeve dhe problemeve qe jane hasur gjate periudhes trevjecare qe nga Kongresi i meparshem, u ndale tek angazhimet aktuale te AOb, te cilat do te jene edhe drejtimet kryesore te punes se saj ne te ardhmen.

Tani dhe ne vitet e ardheshme, thaksoi ai, AOb do te perqendrohet ne dy koncepte per sektorin e arsimit, pikerisht tek ambicia dhe autonomia.

Autonomi, sepse rruga e zgjedhur nga mesuesit i ka mrenjet e veta ne tere sistemin e arsimit dhe trajnimit te tyre, ne zhvillimet e tyre profesionale e personale dhe ne nje organizim shkollos qe i mbashtet ata ne arritjen e ambicieve te tyre. Autonomi qe nuk do te thote isolim, por konsultim dhe percaktim i perbashket i rrugeve dhe synimeve te tyre, ne bashkepunim me prinderit, nxenesit e studentet dhe komunitetin.

Ne vijim, zoti Dresscher scoproi per delegatet ne Kongres, pembajtjen e Kartes Profesionale per mesuesit e Holandes, thalbi i se ciles jane pikerisht ambicia dhe

Me optimizëm, për arritje të reja

Sipas bisedës me z. Mark Lazri, drejtor i shkollës së mesme në Perlat, Mirditë

1

U takuam këto ditë me z. Mark Lazri, drejtor i shkollës së mesme të bashkuar në Perlat, të rrethit Mirditë. Ndër të tjera, ai është autor i tre librave, të botuar vitet e fundit dhe që kanë si tematikë kryesore arsimin. Në një farë mënyre, jeta e tij është e lidhur ngusht me udhën e kësaj shkolle.

Si bir i kësaj krahine, ai tregon se kjo vatrë diturie pret të festojë 90-vjetorin e çeljes së saj. E hapur për herë të parë në prill 1918, kaloi pengesa e vështirësi për mbijetesë. Në fillim, pati 23 djem, me mësues dom Prend Lekën dhe dy vjet më vonë vijuan edhe 3 vajza. Në vitet e mëvonshme shkolla herë hapej e herë mbyllej. Pas çlirimit përsëri ajo ishte fillore dhe në vitin 1951 u bë 7-vjeçare e në 1976 e mesme. Në bankat e saj ka mësuar vetë Marku dhe ka afër 20 vjet që shërben si mësues e drejtues. Po kështu edhe fëmijët e tij e ndoqën këtë shkollë: Adelina (mbaroi Universitetin dhe është mësuese e gjuhë-letësisë), Arturi (mbaroi për mësues bio-kimie), Mimoza (vazhdon vitet e parë të Juridikut në Tiranë) dhe Rira, që sivjet është në vitin e parë gjimnaz.

2

Shkolla e mesme e Perlatit ka një zëvendës drejtor, 17 mësues dhe rreth 250 nxënës, nga të cilët 23 nxënës janë në maturë. Vitin e kaluar e mbaruan maturën 21 veta dhe një pjesë e tyre vijojnë shkollat e larta, në degë të ndryshme. Kolektivi mësues-nxënës i kësaj shkolle dallohet për mirë në shkallë rrethi për arritjet në procesin mësimor-edukativ

dhe në organizimin e veprimtarive të larmishme. Vëmendja e drejtorisë dhe e mësuesve është përqendruar në rritjen e nivelit të nësimnënes, përmes përmirësimit të teknikave të nësimnënes, duke pasur në qendër të tërë punës së tyre nxënësit.

"Me frytshmëri ka qenë organizimi i minianketave me problematikat e shkollës, diferencuar për mësuesit, nxënësit e prindërit, -thotë Marku. -Me përparësi është ndjekur edhe "braktisja e fshehtë. Pozitive është se u mbushën rreth pesë vjet që nuk ka braktisje të shkollës nga nxënësit, brenda detyrimit. Gjithshtu, nuk ka as nxënës të ngujuar për shkak të gjakmarrjes. Sigurisht, ne nuk e nënvlerësojmë këtë dukuri dhe punojmë bashkërisht me komunitetin që mos të kemi kthim mbrapa".

Mësuesi, si figura qendrore e shkollës dhe e komunitetit, vlerësohet si një vlerë e padiskutueshme e të gjitha arritjeve. Tashmë është evidentuar se cikli i ulët është në konsoliduar, si rrjedhojë e punës së përkushtuar të disa mësuesve të dalluar, si: Roza Mrruku, Aqe Picaku, Vitore Lazri, Drandë Picaku. Në shërbim të nxënësve janë kabinetet modeste, që janë ngritur me kujdesin e vetë mësuesve. Por fjalë të mira dëgjon edhe për kopshtin e fëmijëve, ku shërben edukatorja Pranvera Picaku, me rreth 20 fëmijë, në tre grupe të përziera. Kopshti funksionon gjatë tërë vitit dhe kujdesi është përqendruar në përgatitjen dhe aftësimin e fëmijëve për në klasën e parë.

Kur pyet se cili është një ndër

"sekretet" e mbarëvajtjes së punës mësimore-edukative në shkollë e jashtë saj, menjëherë të tregojnë se "çelësi" është lidhja e ngushtë me komunitetin. Me kënaqësi vërehet se prindërit po e kuptojnë çdo ditë e më tepër nevojën e shkollimit të fëmijëve të tyre dhe rolin që ata lipset të luajnë në këtë drejtim, ndryshe nga luhat jet që pati në këtë drejtim në vitet e para të tranzicionit, pas viteve '90. Në bashkëpunimin shkollë-familje, me përparësi ndiqet jo vetëm vijuesmëria e rregullt e nxënësve, por dhe kaluesmëria e cilësia e përvetësimit të njohurive. Këtij qëllimi i kanë shërbyer si takimet vetjake me prindërit dhe ato të organizuara në vijimësi. Funksionon mirë kështu i prindëve, i cili drejtohet nga Merita Hasani dhe që bën mbledhje të rregullta, sipas nevojave që paragjiten. Të gjitha problemet e shkollës i ndjek nga afër edhe kryetari i komunës, Nokë Mrruku. Ndihmesa e tyre ka qenë në drejtim të ruajtjes së kontingjentit të nxënësve, për shtimin e fondit të librave në bibliotekë, për riparimet e ndryshme etj.

3

Kolektivi mësues-nxënës i shkollës së mesme të Perlatit ka një jetë të gjallë edhe pas procesit mësimor. Kështu, sipas planifikimit, me raste festash etj. zhvillohen veprimtari kulturore-artistike dhe fizikulturore-sportive. Synimi kryesor i tyre është edukimi atdhetar i nxënësve. Kanë lënë gjurmë në kujtesën e tyre veprimtaritë e zhvilluara për Nënë Terezën e festat e Nëntorit dhe po bëhen përgatitjet të shunta për Krishtlindjet e Vitit të

Ri 2007. Janë organizuar ekskursione për njohjen e bukurive të natyrës, si te shpella karstike e Valit dhe të ngjarjeve historike në krahinë, si te Kroji i Fikut, ku u bë Kuvendi i Besës, më 1912. Me interes janë ndjekur dhe kanë pasur vlera të shumta edukative veprimtaritë e zhvilluara kundër veseve të dëmtme, si dhani, droga, duna etj.

Që tani ka nisur puna për planifikimin dhe përgatitjen e veprimtarive masive, që do të zhvillohen me rastin e 90-vjetorit të shkollës fillore shqipe në Perlat të Mirditës. Ndër të tjera, do të rishikohet historiku i shkollës dhe i zhvillimit të arsimit në zonë; për këtë ngjarje me rëndësi do të shkruhet në shtypin lokal e qendror. Po kështu, do të përgatitet një fletë-palosje, do të krijohet një miniarkiv me dokumente e kujtime të ndryshme, si dhe do të rifreskohet tërësisht dhokori i shkollës etj.

Është për t'u shënuar se mësuesit e nxënësit e kësaj shkolle marrin pjesë aktive në jetën shoqërore të njëri-tjetrit, sidomos me raste ditëlindjesh

a gëzimesh të tjera familjare. Kohët e fundit dolën në pension nga ky kolektiv mësuesit Pashk Picaku, Gjin Doda e Dedë Koka. Për t'i ndenuar ata, do të zhvillohen veprimtaritë në shkollë e jashtë saj, duke theksuar ndihmesën e tyre të çmuar si nësimdhënës dhe edukatorë të brezit të ri. Por, si për këtë rast dhe për veprimtaritë e tjera në kolektiv, është e dëshirueshme ta thotë në tepër fjalën e

vet dhe të jetë në aktive sindikata e mësuesve.

...Jo vetëm drejtori Mark Lazri, por dhe tërë kolektivi i mësuesve e i nxënësve dhe prindërit e tyre, në shkollën e mesme të bashkuar të Perlatit, në Mirditë, janë optimistë për arritje të tjera më të mira, në vitin e ri që po vjen.

M U R A T G E C A J



Nga Mësonjëtorja e Korçës te Mësonjëtorja e Londrës

Nga Kristaq Laka

1

Në Londër mësova diçka që më mrekulloi. M'u duk se kisha kapërcyer kohët, isha rikthyer te Rilindja, te ajo epokë e ndritur që hapi shkollat, që krijoi alfabetin tonë, që hapi mësonjëtorën e parë shqipe të Korçës. Në mes të Londrës ishte hapur mësonjëtorja e parë shqipe! Le ta quajmë kështu, kështu dhe jo ndryshe. Korçë 1887-2006 Londër. Epokat rrinë mbi njëra-tjetrën, ndryshojnë, por i lidh diçka e pazgjydhshme, diçka e magjishme,

ndrëse mund të jenë larg, me shekuj. I lidh ajo që quhet përparim, progres, modernizëm dhe, mbi të gjitha, pasaporta e përjetëshme e identitetit, gjuha. Në mes qëndron, si monument, historia.

Në mes të Londrës, tek mësova këtë lajm, m'u duk se takova rilindësit dhe përfytyrova mësuesin e madh Petro Nini Luarasi tek e helmonin dhe e hidnin në gropën e gëlqerës, që të mos mësohej gjuha shqipe; m'u duk se ndjeva jehonë krismesh që qëllonin mbi mësuesin Ndreç Ndue Gjoka dhe klithmen trazjike të malësorit: E vranë mësuesin, eeeeejjjjj, që të mos ngjitej

gjër lat në malet e lashta, gjuha e lashtë shqipe! Sa e vështirë paska qënë, drejt ta hajë!

Aq thjesht, me mjete krejt moderne, me dashuri e përkushtim, me respekt, jo në Korçë, por në Londër, hapet një mësonjëtorë, ehu, krejt ndryshe, krejt në mënyrë të tjera. As, krisma, as helme, as klithma, veç përkushtim, ndihmë, dashuri, edhe pse jashtë vendit. Tingëllon ham si habi, ham si ëndër e pabesueshme, ky realitet i ri: një mësonjëtorë shqipe në mes të Londrës.

(Këto m'i tregonte i befasuar një

Vijnë në faqen 12

Vijn nga faqja 11

miku im që kishte qënë për vizitë në Londër. Më tej gjithkush ka të drejtë të thotë se, sot asgjë nuk mund të jetë çudi, ashtu siç ka të drejtë të pyes: Po si, si u ngrit kjo mesonjëtoare në Londër kur shtetet fqinje, ku ka një komunitet të madh shqiptarësh, sa të vështirë e kanë të lejojnë hapjen e shkollave shqip, për fëmijët shqiptarë, që kanë shkuar foshnja ose kanë lindur në dhe të huaj dhe rrezikohet të harrojnë gjuhën shqipe?)

2

Letër nga Shqipëria

Një urdhër paksa i çuditshëm: Mos i ler fëmijët ta harrojnë gjuhën shqipe!

Dëgjo, bir, nuk të kam urdhëruar kurrë, sepse fjala urdhër më është dukur gjithnjë sikur ka lindur e armatosur dhe e veshur me rroba ushtarake, por ky është urdhëri i parë dhe i fundit që të jap, si prind, tani që po u afrohem të tetëdhjetave: mësojua fëmijëve gjuhën shqipe, mos i ler ta harrojnë, se dua të këmbëj me ta një fjalë në shqip kur të vinë nga Londra të më takojnë, apo të këmbëj një telefonatë a një letër. Në këtë pikë mos e dëgjo anglezën (i biri është martuar me një londinezë). Druaj se shumëkush mund edhe të qeshë, pasi mund t'iu dukem jashtë kohe, po ti akoma nuk e di se çob të thotë gjaku i gjakut dhe për më tepër, ca në vonë do ta kuptosh çob të thotë vërtet, krenari për vendin tënd, patriotizëm, edhe pse kjo fjalë sot, kur shekulli i ri eën, ehu, mbi aq shekuj të tjerë. Nuk jam aq nacionalist e, as aq egoist saç mund të mendosh ti. Të gjithë anglezët janë më shumë nacionalistë se sa të gjithë ne shqiptarët. Unë e di se çka thënë anglezi i madh Milton në shekullin e 17-të: "Zoti ka zakon t'u shfaqet, para të gjithëve, anglezëve", nuk u tall me askënd, po u krenua para tërë botës se edhe zoti e ka veçuar mbretërinë që nuk përëndon kurrë, edhe pse ai e dinte fort mirë se në shekullin e parë të erës

sonë, Plutaku talli fort ata të Greqisë së Lashtë që pohnin se hëna e Athinës ishte më e bukur se hëna e Korintit. Iluzionet e patriotizmit nuk mund të rrinë pa u shfaqur ndër shekuj, edhe te unë që e bëj nga malli e dëshira, tani në të shuar të kandilit. Edhe se kemi një diell unë e di fort mirë që ndryshe i ka ngruhur anglezët e ndryshe ne shqiptarët dhe pse kemi bashkëudhëtuar me shekuj e po udhëtojnë edhe në të njëjtin shekull, në shekullin e XXI.

(Nga letra që i dërgonte i ati nga Tirana, të birit emigrant në Londër. Emigrant prej 16 vitesh. Kishte tre fëmijë. Më i madhi 15 vjet. Gjyshi, ende s'i kishte parë nipërit e mbesën dhe donte që të flisnin e të shkruanin shqip. I biri që martuar me një anglezë dhe ai nuk donte që nipërit e mbesa e tij ta harronin shqipën. Por kjo nuk ishte letra e parë me këtë "urdhër" në dukje i rreptë e i çuditshëm. Shunë telefonata, shumë letra, shumë imelle, shumë porosi, shumë biseda nga Shqipëria dhe nga Kosova kishin marrë emigratët shqiptarë të Londrës. Por s'ishte edhe aq e lehtë. Kështu dukej. Po fëmijët, tashmë të lindur në Londër, londinezët e rinj, me prindër shqiptarë apo të përzierë, një angleze e një shqiptar, a dmim?!)

3

Mësuesi: Flisni ndonjë gjuhë të huaj?

Nxënësi: ...Po...flas anglisht.

Një mësues, në një shkollë të Londrës, i tha me shumë dashamirësi një nxënësi: Ju keni një timbër të veçantë në të folurën anglisht. Flisni ndonjë gjuhë të huaj. Nxënësi u skuq. Si të përgjigjej? Nuk ishte i sigurtë: kë të quante gjuhë të tij e kë të quante të huaj. Si u mendua pak tha:

-Flas anglisht.

Mësuesi mendoi se nxënësi bëri shaka dhe, pasi vuri buzën në gaz, e pyeti sërish:

-Ju pyeta nëse flisni ndonjë gjuhë të huaj?!

Dhe ai prapë deklaroi se fliste anglisht.

-Atëhere cila është gjuha juaj?- këmbënguli mësuesi londinez.

.....

-Mund të ma thoni, iu lutem.

-...Po...Gjuha ime është shqipja.

Vetëm atëhere mësuesi londinez mësoi të vërtetën, se ai nxënës ishte "i huaj", ishte shqiptar.

-Ju, dini ta shkruani gjuhën shqipe?

...Nxënësin e kishte mbuluar përsëri purpuri. Ngriti supet duke pohuar se nuk dinte ta shkruante gjuhën shqipe, por dinte ta fliste.

-Ku ta mësoj?!

Mësuesi londinez, i kishte thënë me shaka: krenaria jote qëndroka në lart se krenaria ime. Unë do të bëj çmos që të mësosh të shkruash gjuhën shqipe

(Këtë episod ma tregoi një kosovar tek bisedonim për çështjen e të mësuarit të gjuhës shqipe nga fëmijët e emigratëve që rrodhen në të gjitha anët e botës. "Është dhimbë e madhe, thosh ai, me harru fëmija gjuhën amë". Dhe kishte të drejtë. Ai më foli edhe për shumë episode të tjera të kësaj natyre gjë që tregonte se edhe te fëmijë shqiptarë të lindur nëpër Londër ishte gatitur mendimi se duhet të mësohej gjuha shqipe, që të mos harrohej. Rruga për ngritjen e mesonjëtoares së Londrës po krijonte konturet e veta.)

4

Moretëria e Bashkuar, me sa duket, më shumë se çdo gjë, ka mision bashkimin. Ajo ka bashkuar në gjirin e vet edhe Shqiptarët e Shqipërisë me të Kosovës. Mësimi i gjuhës shqipe në Londër nuk do të kërkonte as vendime të Kongresit të Manastirit as të "Shqipërisë të të shtypurit shkronja shqip", nuk do të kërkonte më shumë

se sa bashkim e përkushtim, për të mësuar atë që s'i ndan kurrë, por i bashkon përjetësisht, gjuhën. I bashkoi ajo si dikur rilindasit dhe diskutuan gjatë me ditë me netë, por në kohë e rrethana të ndryshme, e megjithatë në mes mbetet mësimi i shqipes. Si? Ku? A do të ndihmojnë? Ata nuk harronin për asnjë çast se ishin të huaj dhe po ashtu nuk harronin kurrë se në Londër kishin gjetur mbështetje e përkrahje maksimale dhe se fëmijët e lindur në Angli qenë integruar në botën londineze. Dhe tani duket se qenë zotur kompleksit si të inferioritetit ashtu edhe superioritetit apo të delirimit të madhështisë.

këta fëmijë, për të ardhmen e tyre. Po kudo në botë nisat me fjalë do të mbeteshin në fjalë, si premtime fushate elektorale, nëse nuk do të konkretizoheshin. E, natyrisht, duheshin lekë. Dhe përsëri ajo ndjanjë e shqiptarit që për gjuhën sakrifikon gjithçka, i pagun vetë nga xhepi i tyre dhe e hapnën klasën e parë, mësonjëtoaren e parë në Londër. U hap klasa e parë, pas shumë bisedimesh e përpjekjesh me drejtues të një shkolle fillore. Ishte vërtet një gëzim i madh, por edhe një ditë sa simbolike edhe historike. Në nuk e ndiejnë domethënien e kësaj dite dhe na duket si çudi, por ajo ditë ngjan me mësonjëtoaren, natyrisht jo me ato

kërkesat nriten dita-ditës. Prindërit sa mësojnë që është hapur një shkollë shqipe, interesohen të dërgojnë fëmijët që të mësojnë gjuhën e tyre, shqipen. Edhe një shtet, qoftë edhe i fuqishëm, për një nisje të tillë, do të rrodohej përballë sfidash, le pastaj një grusht emigrantësh. Por kur ekziston dëshira dhe dashuria, çdo sfidë, sfidohet. Klasat u gjetën, fëmijët e prindërit mezi presin, por... Po mësuesit? Ku gjenden mësuesit. Ja ashtu... Mësues u bënë vetë emigrantët që kanë mbaruar arsimin e lartë apo të mesëm në Shqipëri e Kosovë. Kuptohet, përse kanë mvojë këto klasa, këta fëmijë. Për cilësinë e mësimdhënies, për profesionalizëm, për nivele të larta mësimdhëniesje. Po tekstet? Ja ashtu. Ua dërguan nga Shqipëria, privatisht prindërit e të afërmit. Me dashuri e preokupim të madh.

Ishte një kohë që abetaret shqipe prodheshin në botë; në Ballkan, Evropë e Amerikë dhe fluturonin mbi qiej e dete për në Shqipëri, për të rënë fshehurazi në duart e fëmijëve të Shqipërisë. Ilegalisht të mësoje të shkruaje gjuhën e nënës! Dhe sfidat përballëshin në ertër të atij që qhej atdhetarizëm, patriotizëm. Por dhe kur filloi të nësçej legalisht shqipja, ku gjendeshin tekstet?! Ka shumë episode, por do të përmend vetëm një, edhe pse ka të bëjë me familjen time. Patrioti Iazi Laka, nga Shtika e Kolonjës, kishte vite që jetonte e punonte në Amerikë, në Boston e, që atje, bashkë me patriotë të tjerë luftonin për Shqipërinë, për hapjen e shkollave shqipe. Si veprimtar i shquar i shoqërisë "Vatra" në vitin, 1916 që prej andej luftoi me shumë bashkëfshatrë e bashkëkombas të tjerë që në Shtikë, të hopej shkolla shqip. Unis nga Amerika me "bulet" plot me abetare e libra shqip, të gjitha të prodhuara dhe të blera me shpenzimet e veta, duratë për fëmijët

Vijan në faqen 14



Qemal Baku, Afrim Aliu, Daut Dauti, tre shqiptarë nga Shqipëria e Kosova, që prej shumë vitesh, ndoshta që kurse u "çarë" portat, jetojnë e punojnë në Londër, në Britaninë e Madhe, kanë meritën e madhe se u bënë nisjetarë të një nisje vërtet të madhe. Solidariteti ishte ai tipar që i bashkoi dhe i udhëhoqi në këtë ndërmarrje. Fëmijët e tyre që s'dinin si i thonë shqip nënës e babës, duhet të mësonin gjuhën shqipe. Bashkë shqiptarët e kosovarë, rrahën mendime në Shoqatën e tyre me emrin kuptimplotë "Bashkimi" që kishin krijuar më përpara. Përse sakrifikan, përse kapërcyen detet e gjetën tokën e kërkuar për një jetë në të mirë, për

përmasa.

Filloi mësimi. Gjithsej 63 nxënës të ndarë në dy klasa; Në një klasë mësonin fëmijët e moshës 5-10 vjeç, në tjetrën fëmijët e moshës 11-15 vjeç. Ovarri i shkollës mbushur plot me prindër shqiptarë e londinezë... Pjesa më e madhe e fëmijëve me prindër shqiptarë, por edhe fëmijë me prindër të përzierë, angleze me shqiptar e anasjelltas, shqiptarë me anglez. Mësimi do të zhvillohej vetëm gjatë ditëve të fundjavës, sëmijadiset në ditët e tjera qenë të zëna. Kështu u nbyll viti i parë. Filloi viti i dytë. Interesimi jashtëzakonshëm. Numri i nxënësve u dyfishua. Arriti në mbi 120. Dhe

Vijon nga faqja 14

e Shtikës, që do të shkolin në klasën e parë, me ta edhe nipit i tij. Dhe kur e përgojuan pse nuk i kishte sjellë nga Amerika të nipit, ca mroba për të veshur, ishte përgjigjur se kishte sjellë dituri, përgjithë fëmijët e fshatit se kjo është veshja më e bukur. Të mësonin fëmijët e fshatit, e vetmja ambicje

bashkëfshatarëve). Për nder të tij bashkëfshatarët i vunë emrin Shkolla fillore "Lazi Laka". Edhe sot e kësaj dite godina shërben si shkollë e ciklit të ulët të shkollës 9-vjeçare të Shtikës.

(Ishte një kohë që Librat shqip i sillnin apo i dërgonin shqiptarët në emigracion nga Amerika, nga Stambolli, nga Rumania, nga Sofia

pasaporta e identitetit. Por ne duam që të mos e harrojnë e ta mësojnë shqipen fëmijët jashtë vendit. Dhe ata falë përpjekjeve që bëjnë prindërit po mësojnë. Po shteti? Shteti... Sa larg qëndron shteti! Po janë shqiptarë e, po të ishin në Shqipëri, do të duheshin nësuas, klasa, tekste... Mos i harroni!

Në shqiptarët, ndryshe nga të tjerët, dihet përse, identifikohemi me shtetin edhe pse nga shteti e kemi pësuar vazhdimisht. Shqiptari e ka ndjerë veten gjithnjë një nënshtetas, domethënë një i nënshtuar nga shteti dhe jo një individ shtetas që i kërkon shtetit llogari. Prandaj thënia e Hegelit: "Shteti është realiteti i idesë morale", merr te ne trajtën e një shkakje të hidhur. Shurë e dinë se: Më urgjenti i problemeve të epokës sonë është futja e shtetit edhe në veprimet e individit, larg modeleve që të lenë në fyt shënjën e lakut, por të veprimeve që të vendosin raporte të drejta individ - shtet e të paktën të ketë një minimum të rreptë qeverisjeje, për së miri jo për së keqi. Qëllimi i denjë, i drejtë, por i pafajshëm i shqiptarëve londinezë që hapën mësonjëtorën e Londrës për fëmijët e tyre, është një udhërrëfyes dhe vlen për të përsosur tiparet në të mira shqiptarit, edhe në kohët moderne.

(Po ktheham përsëri te biseda e parë me njeriun që kishte qëndruar në Londër dhe që befasuara e mrekulluar nga londinezët shqiptarë. Ndërsa ecja nëpër Londrën e ndritur, dështa të lëshoja një pikantë, një klithmë si ajo e malësorit që njoftonte vrasjen tragjike të mësuesit. Jo "E vranë mësuesin, dheeejjjj", por "Dërgoni mësues dheeejjjj, dërgoni libra, dheeejjjjj! Kështi do të ecim vallë? Si jetinë? Ata të Londrës ecën pa asnjë sprasje, pa asnjë dëstim. Do të ishte vërtet turr të dështonte një nisnë e tillë. Prandaj në këtë rast fjala "alam!" do të kishte vërtet kuptim. Kush tha që ishin të vonuar rilindësit!? Në se Rilindësit qanë të vonuar ne nuk meritojnë të ziramë në gojë).



madhore e tij. Dhe u hap shkolla në shtëpinë e një fshatari arsindashës. Por hapja e shkollës rregullisht do të bëhej më 1920, pasi hasi në pengesa të mëdha nga grekët. Kështu që Lazit ju desh që të vinte përsëri në Shtikë. Ai bisedoi me patriotë të tjerë. Shkoi edhe në Qinan, fshat në kufi me Shtikën e bisedoi me patriotin Hasan Qinami, njeri me autoritet të madh, me influencë, i mençur dhe trim, të cilit i kërkoi ndihmë. Dhe Hasan Qinami s'e bëri të gjatë. U nis për në Shtikë me njerëzit e tij të hipur mbi kuaj. Ke ardhur si për dasëm, i thanë Hasan Qinamit në Shtikë. Po, që përgjigjur Hasani, kjo është dasmë më e madhe, është dasma e shkollës shqip. Kishte marrë me vete edhe mësuesin e gjuhës shqipe. Përzuri mësuesin e gjuhës greke e hipi mësuesin e shqipes në katedër dhe tha: këtej e tutje këtu le të flitet vetëm shqip. Vite më vonë, më 1936-1937, Lazi Laka do të vinte përsëri në Shtikë dhe do të ndërtonte me shpenzimet e veta shkollën e fshatit (edhe me kontributin vullnetar të

etj. në Shqipëri. Tani s'dërgojmë dot libra për fëmijët tanë emigrantë, nga Shqipëria. Nga biseda me një emigrant).

5

Emigracioni po sjell çuditira dhe mrekullira. Shqiptarët kudo që janë, jetojnë të lidhur me mijëra fiqe me vendin e tyre, me njerëzit e tyre, me kujtimet e tyre. Ata ndoshta në shpejt edhe se shumë bashkëatdhetarë në Shqipëri i mësojnë lajret të parët. Se i mbajnë veshët pipzë nga vendi i tyre, se i mbajnë sytë e zemrën nga vendlindja e tyre, por tani ka dalë interneti kjo mrekulli që t'i sjell lajret menjëherë. Në mes është malli dhe ajo që mund të tingëllojë paksa e çuditëshme dhe arkaike për disa: patriotizmi. Le të flasë për Shqipërinë, dikush që nuk është shqiptar, pa shprehur se si gjendesh mes emigrantësh... S'të lenë të thash asnjë gjysëm llafi, ashtu si për rënë.

Në kohët moderne, në kushtet e emigracionit, është shumë e lehtë të humbasë e të harrohet gjuha,

Të reja shkencore

SHPËTUESI I GISHTAVE

Dhëmbët rrotullues në një teh tryeze për të sharruar



lëvizin me 120 milje në orë. Kjo bën që ato të jenë shumë të dobishme për të prerë dru. Fatkeqësisht ato janë edhe shumë të rrezikshme për gishtat e njeriut. Por edhe për këtë një zgjidhje është gjetur kohët e fundit. Tryeza e sharrimit që shihni në foto është e pajisur me sensorë të teknologjisë më të re që

arrijnë të dallojnë kur tehu i sharrës prek në mishin e butë të njeriut. Në pak milisekonda tehu i sharrës ndalon dhe fshihet në brendësi të pajisjes duke lënë vetëm një të prerë shumë të vogël dhe të papërfillshme në gisht.

Çmimi i kësaj pajisje është 2.800 \$.

KRIJUESI I SHIUT

Shkrimtari i librave fantastiko shkencore Arthut Clarke dikur ka shkruar se "teknologjitë e avancuara nuk ndryshojnë nga magjitetë". Ja edhe shëmbulli: kjo makinë-prodhuese e ujit mund të nxjerrë, si me magji, deri në 500 galon ujë të pijshëm në ditë nga ajri i freskët. Elementët e saj ekzakt nuk janë bërë publik, por ajo përdor një proces kimik të ngjashëm me atë që shkakton që kripa të thithë lagështi nga

ajri (mënyra si mblidhet në kripore). Makina e ujit nuk është shumë praktike, pasi është 20 feet, (afërsisht 6 m



e 10 cm) e gjatë, por do të ishte shumë e nevojshme në raste fatkeqësish natyrore, sidomos në shkretëtira.

NDIHMA "REALIVE"

Pacientët që kanë humbur forcë dhe ndjeshmëri në një krah mund të ndihmohen nga "Realive", një veshje robotike që përdor lëvizjen e gjymtyrës së shëndetshme

për të ndihmuar në rehabilitimin e të dëmtuarës. Kur pacienti përkul krahun e



pacënuar, sensorët kapin aktivitetin dhe u dërgojnë sinjale muskujve prej llastiku që mbështjellin gjymtyrën tjetër të cilët më pas imitojnë lëvizjen e krahut të shëndetshëm.

Kjo pajisje do të jetë e disponueshme rreth vitit 2011.

Keshilla praktike

12 SHENJA QË TREGOJNË SE JENI NË PRAG TË PUSHIMIT NGA PUNA

Mendoni se një letër që ju informon se jeni të pushuar nga puna mund të jetë rrugës? Shumica e njerëzve e dinë që koha e tyre ka mbaruar ose (në retrospektivë) thonë që duhet ta kishin dalluar.

Ja ku janë 12 shenja që ju tregojnë se puna juaj është në rrezik

1. NUK JENI MË PJSË E GRUPIT

Ju nuk merrni më njoftime që më parë për të reja ose raportet e kompanisë dhe duket se keni humbur zërin për sa u përket çështjeve organizative. Ju nuk ftoheni më në takime apo mbledhje në të cilat normalisht ishit prezent.

2. SHEFI JUAJ JU KONTROLLON DUKE PRITUR QË TË BËNI DIÇKA GABIM

Ndjeheni sikur po vëzhgoheni me kujdes dhe se shefi nuk ka më besim te ju. Vendimet tuaja diskutohen më mënyrë të vazhdueshme, faturat e shpenzimeve shqyrtohen me mikroskop dhe keni më pak liri veprimi për të punuar në mënyrë të pavarur.

3. PO TRAJTOHENI FTOHTË

Dikur ju i dinë të gjitha të reja më të bujshme, në lidhje me punën apo me jetën private. Tani kolegët tuaj ju evitojnë dhe biseda e fundit që patët me eprorët tuaj ishte një përpjekje e dobët me batuta për të qeshur.

4. RAPORTI PËR PUNËN TUAJ ISHTE I DOBËT

Morët vërejtje për përmbushjen e detyrave tuaja dhe një sërë reagimesh negative. Nëse merrni një paralajmërim ose ju është dhënë një plan për përmirësim është me të vërtetë koha për të filluar të bëni gati plaçkat.

5. SHEFI PO JU LË SHËNIME ME LETRA

Shefi komunikon me ju kryesisht me letra. Ju merrni shënime që theksojnë gabimet, që kritikojnë përmbushjen e detyrave tuaja dhe që konfirmojnë çdo takim ose bisedë që mund të keni ju të dy.

6. JU DHE SHEFI JUAJ NUK PO SHKONI MIRË

Menaxheri i korporatës do t'ju betohet që nuk është personale,

megjithatë shumë shkurtime janë mënyra për të larguar punonjës jopopullor te vendosur "në listën e zezë". Performanca në punë gjykohe në mënyrë subjektive dhe ka më shumë mundësi që menaxherët të largojnë njerëz që ata nuk i pëlqejnë.

7. DREJTUESI JUAJ ËSHTË LARGUAR

Eprori që ju ka mbështetur gjithmonë është larguar nga kompania ose nuk ka më fuqi të mjaftueshme.

8. I PRISHËT PUNËT PUBLIKISHT

Ju keni bërë një gabim në të shprehur që vuri në siklet shefin tuaj apo bëri që kompania të dukej keq. Ose jeni pjesë e një grupi që bëri një gabim trashanik dhe ka nevojë që "të bëjë kurban" dikë.

9. TË RINJTË KANË MARRË PUSHTETIN

Kompania juaj është gati të shkrihet, të blihet ose t'i nënshtrohet riorganizimit dhe lideri juaj papritur

zhduket. Të rinjtë janë bërë vala e së ardhmes dhe ju është dhënë urdhri të "lëvizni"

10. PO SHTYHENI TË DËSHTONI

Ju është caktuar një territor i padëshiruar ose ju është dhënë një detyrë e pamundur me afate joreale dhe pak ndihmë.

11. JU JANË HEQUR DISA DETYRA

Ju është kërkuar të hartoni një raport me të gjitha projektet me të cilat po punoni dhe po shtyheni me presion për të përfunduar një ose dy projekte specifike. Ose ju janë hequr detyrat tuaja thelbësore në mënyrë që të punoni me "projekte të veçanta" pa kuptim. Inkurajoheni të mos bëni planifikimet e zakonshme me afat të gjatë.

12. PO DËGJONI ZËRA

Nëse po dëgjoni zëra për largimin tuaj, tregohuni të kujdesshëm: "Aty ku ka tym, ka zjarr".

Përgatiti faqen Erica Vargjeli

Tribuna sindikale

